

# Raporti i v.2010 i Analizave të Përqendruara tek Mendimet e Qytetarëve Cilësia e Shërbimeve Sociale



Dy herë më shumë të anketuar perceptojnë se cilësia e shërbimeve sociale të ofruara në komunitetin e tyre është e standardit të mirë, krahasuar me shërbimet sociale të ofruara në nivel nacional.

Kapitulli i fundit i këtij publikimi ngre çështjen e cilësisë së shërbimeve sociale, shërbimeve arsimore, shërbimeve sociale për familjet, të moshuarit, të paaftët dhe të pambrojturit, si dhe përpjekjet për deinstitutionalizim. Ai shtjellon një analizë të hollësishme për perceptimet e njerëzve mbi cilësinë e shërbimeve sociale me të cilat ato kanë kontakt. Analiza kryesore përshkruan kënaqësinë e të anketuarve me shërbimet sociale, zgjedhjen dhe pjesëmarrjen në institucionet e shërbimeve sociale, dhe ndikimin mbi shpërndarjen e shërbimeve sociale. Fakti se mbi gjysma e njerëzve vlerësojnë se shpërndarja e shërbimeve lokale me cilësi të mirë, është një tregues i tërthortë i suksesit të procesit të decentralizimit dhe i bartjes së përgjegjësisë nga qeveria qendrore tek ajo lokale. Megjithatë, mbetet ende shumë për t'u bërë për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve sociale.

Shoqatat e biznesit, sindikatat ose OJQ-të mund të jenë mjete për të ushtruar presion ndaj autoriteteve lokale për të përmirësuar shërbimet e tyre, duke ushtruar 'zërin' e tyre. Shoqëria civile në Republikën e Maqedonisë që nga pavarësia është rritur në një forcë të konsiderueshme, me organizata të ndryshme që përfaqësojnë interesat e ndryshme të popullatës. Ekziston një sërë ndërmarrjesh sociale në të gjithë vendin, madje edhe në zonat rurale. Roli i ndërmarrjeve sociale dhe OJQ-ve mund të jetë i dobishëm për përmirësimin e qeverisjes lokale. OJQ-të mund të luajnë një rol të rëndësishëm për të ndikuar njerëzit që të marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes në nivel lokal. Donatorët ndërkombëtarë duhet të marrin parasysh prezantimin e programeve që do të ofronin grante ose ndihma për ndërmarrjet sociale dhe OJQ-të, të gatshme për të ndërmarrë projekte të tilla.

**Shumica e njerëzve besojnë se qeveria qendrore do të bëjë punë më të mirë se sa qeveria lokale lidhur me ofrimin e shërbimeve të arsimit, shërbimeve për të moshuarit, për fëmijët dhe për të paaftët.**

## Cilësia e Shërbimeve Sociale

Përqindja e të anketuarve që shprehin pikëpamjet e tyre mbi:	Mirë	Mesatare	Keq
Cilësinë e përgjithshme të shërbimeve sociale	16%	44%	34%
Cilësinë e shërbimeve sociale në lokalitet	31%	43%	22%

Më shumë vëmendje duhet t'i kushtohet stimujve për të ngritur pjesëmarrjen e njerëzve në menaxhimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale. Autoritetet lokale duhet të punojnë për të shtuar angazhimin e njerëzve në proceset e vendimmarrjes (një shembull i mirë për këtë është BNJVL).

Për sa i përket arsimit, përpjekjet qeveritare për të ngritur shkallën e pjesëmarrjes në institucionet e arsimit të lartë do të jenë të pavlefshme nëse kërkesa e cilësisë së njohurive të nxënësve që diplomojnë nga shkolla filllore dhe të mesme është e ulët. Arsimi i ofruar në pikëpamje të përmbajtjes duhet të jetë i dobishëm për brezat e rinj. Është me rëndësi për t'u siguruar që stafi pedagogjik është me kualifikim akademik dhe nuk është i punësuar për shkak të anëtarësimit në parti apo lidhjeve familjare. Gjetjet e Raportit tregojnë se qeveria qendrore do ta bëjë më të mirën për të ofruar shërbime të arsimit, shërbime për më të moshuarit, për fëmijët dhe për të paaftët.

Sondazhi tregon se njerëzit nuk kanë informata të mjaftueshme mbi punën e autoriteteve komunale. Njerëzit e informuar mirë janë një domosdoshmëri për të bërë politika dhe zhvillim të shëndoshë. Qeveritë vendore duhet të prezantojnë më tepër transparencë në punën e tyre dhe duhet të ofrojnë më shumë dhe informim më të mirë për shërbimet sociale të cilat i ofrojnë. Autoritetet komunale duhet të përdorin mjete alternative në dispozicion për sigurimin e shërbimeve sociale në nivel lokal, siç janë bashkëpunimi ndërkomunal, ose nënkontraktimi për shpërndarjen e shërbimeve.

### Është me rëndësi që të përmirësohet komunikimi lidhur me punën e qeverive lokale.

*Best service providers according to respondents:*

Përqindja e të anketuarve të cilët dëshirojnë që shërbimi të ofrohet nga:	Shërbimet e arsimit	Shërbimet për më të moshuarit	Shërbimet për fëmijët	Shërbimet për të paaftët
Qeveria qendrore	69%	61%	63%	69%
Qeveria lokale	28%	32%	30%	23%
Ofruesit privatë	2%	2%	2%	2%
OJQ-të	1%	5%	5%	6%

Rreth serive të Raportit të Analizave të Përqëndruara tek Mendimet e Qytetarëve: Raporti i v. 2010 i Analizave të Përqëndruara tek Mendimet e Qytetarëve vazhdon të ekzaminojë trendet dhe aspektet e përfshirjes sociale siç është bërë që nga botimi i tij i parë në mars 2008, ku fokusi kryesor i Raportit ishte përfshirja sociale e ekzaminuar përmes thjerrëzave të dimensioneve Qeverisë dhe Etnike. Kjo seri raportesh vazhdoi me botimin e dytë në prill 2009, ku fokusi kryesor vihej tek zhvillimi Rajonal dhe Cilësia e jetës. Secili raport mbështetëj tek gjetjet e sondazhit me 1,000 të anketuar (3000 të anketuar për raportin e dytë Rajonal) në gjithë vendin me mbështetje financiare nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Këto raporte synojnë krijimin e hapsirës për hulumtime profesionale, të paanshme, të balancuara, pragmatike dhe konstruktive të politikave dhe të kapaciteteve në vend, me vlerësime mbi rritjen e përfshirjes dhe poliktikbërjen e bazuar mbi evidencën, cilësinë e qeverisjes dhe përfundimisht mbi jetët e njerëzve.

**RRETH KONCEPTIT TË PËRFSHIRJES SOCIALE:** Përfshirja sociale përcakton vlerat e një shoqërie me anë të njohjes së "detyrës për t'u kujdesur" të qeverisë për të siguruar të gjitha mjetet e nevojshme për çdo person që të jetë pjesë e shoqërisë moderne me mundësi të barabarta sociale, ekonomike dhe/ose politike. Ajo poashtu adreson të gjitha format e pabarazisë brenda-shtetit. Përfshirja sociale është përgjigje ndaj mangësive institucionale, që është një proces afatgjatë i cili kërkon ndryshime në qëndrimet sociale dhe raportet e pushtetit. Ajo poashtu ka një anim operacional, që planifikon përgjigjet e politikave të realizueshme, duke njohur në mënyrë efektive se Shteti ka 'detyrë për t'u kujdesur' për të përfshirë të gjithë pjesëtarët e shoqërisë në proceset politike, ekonomike dhe sociale. Aq më tepër, përfshirja sociale duhet t'u përgjigjet diskriminimeve të ndryshme si gjinia, moshë, etniciteti ose paaftësia, etj.

**RRETH UEJL-së:** Universiteti i Evropës Juglindore është institucion i arsimit të lartë në vitin e tetë të veprimtarisë së vetë. Nga hapja e kampusit në Tetovë në tetor 2001, ai ka arritur të ngritet në një universitet të drejtuar nga cilësia dhe financiarishti i qëndrueshëm. Ai shikohet tash si model i arsimit të lartë shumëetnik, shumëgjuhësor në Evropën Juglindore. Ka arritur të bëjë kombinimin e përvojës më të mirë evropiane dhe amerikane dhe ka vazhduar të përfitojë nga bashkëpunimi akademik i sponsorizuar nga Komisioni i BE-së dhe USAID-i, krahas donatorëve të tjerë. UEJL arrin tek institucionet tjera duke promovuar bashkëpunimin në fushën e hulumtimeve, shkëmbimin e studentëve dhe stafit dhe në komunitetin e tij. [www.seeu.edu.mk](http://www.seeu.edu.mk)